



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI ShA
Ferizaj



Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel&Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

KONTRATË

KRU Bifurkacioni ShA Ferizaj (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), në njërën anë dhe

NT Rilindja Commerc nga Ferizaj me nr. unik identifikues 810637522 (në vazhdim Operatori Ekonomik), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me material shpenzues administrative dhe tonera për nevojat e KRU Bifurkacioni
me nr. prokurimi 600-KRU BIFURKACIONI ShA-19-6961-1-3-6 dhe me nr. të brendshëm 600.19.028.136

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës është: **Furnizim me material shpenzues administrative dhe tonera.**

1.2 **Kontrata hyn në fuqi me 15.10.2019 dhe përfundon më datë 14.10.2020.**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve është **KRU Bifurkacioni ShA Ferizaj.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë *DDP (Detyra e Dërguar e Paguar-Incotermis 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare).*

Neni 2

Ligji aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës është **6.697,00 € (gjashtëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjet e shtatë Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për furnizimet (sipas specifikacionit teknik) do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha furnizimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe dates aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa realizuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, mjeshtërinë dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nënkontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilën Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11

Ndërprerja e kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1 Autoriteti Kontraktues mundet që, pasi t'i jep Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrative të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori Ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12

Ndërprerja e kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti Kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) Vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) Si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë material të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen Operatorit Ekonomik.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedure gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditëve nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Themelore në Ferizaj në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14




Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim, lidhur me këtë Kontratë, ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik, duhet të jep titullin e kontratës, numrin e identifikimit dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Kontrata është hartuar në 3(tre) kopje origjinale, 2(dy) kopje origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe 1(një) kopje original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri	BUDAR TAHIRI	Emri	OSMAN BERISHA
Pozita	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita	DIREKTOR
Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Data	15.10.2019	Data	15.10.2019
Vula		Vula	